



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Illir Halili	20.11.2024	06.12.2024	2024/1121

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.11.2024, OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/1121, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirembajtja dimerore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme ne Komunën e Graçanicës” me nr. të prokurimit: "GRA618-24-10315-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 140,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankesës.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

1. AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aspak aktiv për t'u siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive, ekonomike dhe vetëm për qëllimin e lëndës. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit për këtë procedurë. Më saktësisht AK pa asnjë të drejtë ligjore po mundohet ta anuloi tenderin vetëm sa për të mos na shpërblyer neve me kontratë si GOE i vetëm i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Arsyetimi i AK-së tek anulimi i tenderit nuk përkon me asnjë nga mundësitë e anulimit të tenderit pas hapjes publike që i lejon neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-001/2022. Mos aplikimi si duhet i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit e shtynë AK-në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 6 të LPP-së por edhe drejt shkeljeve tjera sepse me këtë veprim po tenton që në kundërshtim me realitetin si dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së të anuloi tenderin.

Në këtë tender jemi të vetmit si tenderues i përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesit tjerë të papërgjegjshëm andaj shpërblimi jonë me kontratë është detyrim ligjor ku veprimi ndryshe konsiderohet shkelje e plotë dhe mos shfrytëzim i mjeteve në formën më efikase, efektive dhe më ekonomike siç e kërkon nenin 6 i LPP-së.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve tjera të cekura në vazhdim në pretendimet tona.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër asaj që ne jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm dhe posedojmë çmimin më të ulët në krahasim me të gjithë aplikuesit tjerë, AK nuk po na shpall fitues por në mënyrë të kundërligjshme për tenton ta anuloi tenderin në fjalë. Ky anulim dyshohet se po bëhet për të i favorizuar dhe për

5/11

të ju dhënë edhe një mundësi GOE-ve që tani në këtë tender nuk kanë arritur të jenë të

përgjegjshëm dhe nuk kanë arritur të ofrojnë as çmimin më të ulët.

Vlen të theksohet se GOE që posedojnë çmime më të larta se ne, janë të papërgjegjshëm si për nga aspekti i plotësueshmërisë së kërkesave për pajisjet e po ashtu edhe për nga mënyra e ofrimit të çmimeve tek paramasa. Nga dokumentet e tyre shihen qartë se tenderët e tyre janë jo të rregullt prandaj mos trajtimi i tyre si tenderues të papërgjegjshëm dhe tentimi për anulim të tërë procesit nga ana e AK-së, konsiderohet favorizim i plotë ndaj tyre dhe tentim për një mundësi të dytë në rishpallje ose kontraktim me negocim. Kjo nuk është vetëm favorizim, por në një formë është edhe bashkëpunim në manipulim me GOE-et në fjalë që nuk janë të përgjegjshëm. Kjo nuk lejohet me asnjë nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit andaj shihet hapur se AK i ka favorizuar të njëjtit.

Detajet e mangësive në ofertat e tyre do të shpalosim më detalisht në pretendimet tjera ku do ta argumentojmë papërgjegjshmërinë e tyre përmes dëshmive. AK ka shkelur nenin 7 duke na diskriminuar neve pa asnjë të drejtë ligjore pasi që edhe pse jemi të vetmit si të përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim me konkurrencën, nuk shpallemi fitues.

Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë, favorizimin dhe në të njëjtën kohë diskriminimin e tenderuesve.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk i ka aplikuar fare kërkesat e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të publikuar për këtë qëllim. AK ka bërë shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së me rastin e tentimit për anulim të tenderëve pa i vlerësuar fare ata. Në fakt AK i ka vlerësuar ata dhe vetëm kur e ka kuptuar se dy GOE-të që posedojnë çmimin më të lartë se ne janë të pasuksesshëm dhe të papërgjegjshëm, atëherë ka filluar tentativën për të gjetur shkas dhe për ta anuluar tenderin. Anulimi i tenderit është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022. Në vazhdim po i rendisim mangësitë e GOE që AK nuk i ka vlerësuar fare.

Mangësitë në tenderin e GOE “NNT ABC SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.”:

Ky Grup i OE fillimisht ka mangësi tek paramasa pasi që disa nga çmimet i ka ofruar me më shumë presje dhjetore se sa që lejohen me ligj dhe me dosje së tenderit. Në rastin konkret tek pozicioni 2.10, 2.11 dhe 3.04 ka ofruar çmimin 0.004€, 0.004€ përkatësisht 0.001€. Kur të merret për bazë ajo që e kërkon neni 17.11 i RRPP-001/2022, del që tenderuesi i tillë është i papërgjegjshëm.

Mangësia tjetër e këtij GOE është mos dorëzimi i organogramit sipas ligjit dhe rregullores mbi organizmin e kompanive pasi që ky organogram i posedon vetëm katër pozitat udhëheqëse dhe nuk dihet fare se sa është numri i punëtorëve e as si është shpërndarja e tyre nëpër sektorë.

Mangësi tjetër e rëndësishme është ajo e mos posedimit të pajisjeve sipas kërkesave të AKsë. E themi këtë sepse ky GOE nuk ka ofruar dëshmi të vlefshme si në vazhdim:

- Tek pika 7 e listës së pajisjeve nuk ka dhënë informata mbi fuqinë e makinës ashtu siç e ka kërkuar AK-ja. Kur të qasemi në internet, tipi i makinës së tillë nuk posedon 6/11

fuqinë e kërkuar nga AK andaj edhe nuk mundet të pranohet. Ky GOE tek fajlli 14, faqe 48-49 ka paraqitur një faturë të plotësuar me dorë të lirë dhe ka dhënë fuqinë 138KW por që dyshohet se nuk është vërtetë pasi që makineria e njëjtë në internet nuk posedon fuqinë e tillë. Për tu bindur me këtë, shihe linkun për pajisjen e tillë:

<https://www.troostwijkauctions.com/en/l/o-k-125-5-shovel-2002-A1-22288-13>

- Tek pika 8 e listës është paraqitur kompresori si gjysmërimorkio speciale-kompresor që tërhiqet ku sipas ligjit për regjistrim të automjeteve në RKS, ky mjet duhet të regjistrohet sepse kalon peshën mbi 750kg. Tek fatura e paraqitur në PDF si dhe tek DUD-i i doganës shihet se pajisja e tillë peshon 1990kg andaj paraqitja e sajë pa regjistrim nuk mundet të pranohet.

- OE ka ofruar kokë tërheqëse me targa 01-967-QQ dhe gjysmërimorkio për bartjen e automjeteve me targa: 01-659-XB. Dokumentin e gjeni si PDF tek fajlli 15 faqe: 12-

13-14-15. Kërkesa e AK-së ka qenë KAMAION PER TRANSPORT TE

MAKINERISË, që do të thotë se është kërkuar vetëm një pajisje e jo kombinim i dy tre pajisjeve si koka tërheqës dhe gjysmërimorkio. Si plotësim i kërkesës në formën e modifikuar ligjërisht nuk mund të pranohet.

Mangësitë e tilla që i cekëm më sipër e bëjnë GOE në fjalë si tenderues të papërgjegjshëm.

Mangësitë në tenderin e GOE “B CORP SH.P.K.; FS C ING SH.P.K.”:

Fillimisht dua të sqaroj se të dy këto Grupe të OE posedojnë tenderin e njëjtë me staf, pajisje, organogram por edhe me gabime të njëjta tek çmimet andaj ne vetëm po i përsërisim mangësitë e njëjta.

Ky Grup i OE fillimisht ka mangësi tek paramasa pasi që disa nga çmimet i ka ofruar me më shumë presje dhjetore se sa që lejohen me ligj dhe dosje së tenderit. Në rastin konkret tek pozicioni 2.10, 2.11 dhe 3.04 ka ofruar çmimin 0.004€, 0.004€ përkatësisht 0.001€. Kur të merret për bazë ajo që e kërkon neni 17.11 i RRPP-001/2022, del që tenderuesi i tillë është i papërgjegjshëm.

Mangësia e këtij GOE është mos dorëzimi i organogramit sipas ligjit dhe rregullores mbi organizmin e kompanive pasi që ky organogram i posedon vetëm katër pozitat udhëheqëse dhe nuk dihet fare se sa është numri i punëtorëve e as shpërndarja e tyre në sektorë.

Mangësi tjetër e rëndësishme është ajo e mos posedimit të pajisjeve sipas kërkesave të AKsë. E themi këtë sepse ky GOE nuk ka ofruar si në vazhdim:

- Tek pika 7. e listës së pajisjeve nuk ka dhënë informata mbi fuqinë e makinës ashtu siç e ka kërkuar nga AK. Kur të qasemi në internet, tipi i makinës së tillë nuk posedon fuqinë e kërkuar nga AK andaj edhe nuk mundet të pranohet. Ky GOE ka tek fajlli 12, faqe 50 ka paraqitur një faturë të plotësuar me dorë të lirë dhe ka dhënë fuqinë 138KW por që dyshohet se nuk është vërtetë pasi që makineria e njëjtë në internet nuk posedon fuqinë e tillë. Shihe linkun për pajisjen e tillë:

<https://www.troostwijkauctions.com/en/1/o-k-125-5-shovel-2002-A1-22288-13>

- Tek pika 8 e listës është paraqitur kompresori si gjysmërimorkio speciale-kompresor

qe tërhiqet ku sipas ligjit për regjistrim te automjeteve ne RKS, ky mjet duhet te regjistrohet sepse kalon peshën mbi 750kg. Tek fatura e paraqitur në PDF si dhe tek DUD-i i doganës shihet se pajisja e tillë peshon 1990kg andaj paraqitja e sajë pa regjistrim nuk mundet të pranohet.

7/11

- OE ka ofruar kokë tërheqëse me targa 01-967-QQ dhe gjysmërimorkio për bartjen e automjeteve me targa: 01-659-XB. Dokumentin e gjeni si PDF tek fajlli 15 faqe: 12-13-14-15. Kërkesa e AK-së ka qenë KAMAION PER TRANSPORT TE MAKINERISË, që do të thotë se është kërkuar vetëm një pajisje e jo kombinim i dy tre pajisjeve si koka tërheqës dhe gjysmërimorkio. Si plotësim i kërkesës në formën e modifikuar ligjërisht nuk mund të pranohet.

Mangësitë e tilla që i cekëm më sipër e bëjnë edhe këtë GOE në fjalë si tenderues të papërgjegjshëm.

Sipas kësaj po shihet se AK qëllimisht nuk ka vazhduar me përzgjedhjen e fituesit edhe pse ne kemi qenë të përgjegjshëm dhe kemi pasur çmimin më të ulët. Grupet e OE-ve që janë të papërgjegjshëm posedojnë pajisjet, stafin si dhe shumë elemente tjera identikisht të njëjta andaj këtu dyshohet për një marrëveshje të fshehtë në mes tyre ku faktin e tillë na e vërteton edhe vet AK pasi që nuk vazhdon me na përzgjedhë neve si fitues të tenderit por tenton ta anuloj atë. Kjo përpos që konsiderohet diskriminim ndaj nesh dhe favorizim ndaj tyre, është shkeljet e plotë edhe e nenit 59 të LPP-së.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar dispozitat në të cilat thuhet se OE duhet së pari të jetë i përgjegjshëm e më pas të ketë çmimin më të ulët. Në rastin tonë AK është dashur të na shpallte neve si fitues sepse i plotësojmë të dy kriteret e nevojshme andaj me të drejtë konstatojmë se AK e ka shkelur nenin 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022 me rastin e anulimit të tenderit dhe shkelja e tillë vjen si pasojë e mos respektimit të nenit 7, 59, dhe 69 të LPP-së që AK i ka shkelur gjatë procesit të vlerësimit. Po që se do respektoheshin si duhet kriteret e

dosjes së tenderit dhe vlerësimi do bëhej në përputhje me nenet e cekura më lartë, AK do kishte në mesin e tenderuesve një Grup të OE që i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderi dhe që posedon edhe çmimin më të ulët në krahasim me të gjithë tenderuesit konkurrues, kështu që nuk do ishte fare e nevojshme për ta anuluar tenderin. Pas analizimit dhe verifikimit të ofertave të të gjithë OE(GOE) konkurrent në këtë tender, shihet se të gjithë tenderuesit tjerë ishin të papërgjegjshëm dhe se tenderi i vetëm që i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga AK dhe që ishte plotësisht i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ishte Grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K. & Enggroup SH.P.K.”. Nisur nga kjo lirisht mund të konstatohet se aplikimi i anulimit të tenderit është bërë qëllimisht dhe pa asnjë arsye reale për çka lirisht mund të thuhet se është bërë vetëm për të mos na e dhënë neve këtë tender. Arsyetimi i anulimit të tenderit që AK e ka publikuar duket kështu:

KOMUNA E GRACANICËS anulon¹ aktivitetin e prokurimit bazuar në kërkesën e njësisë kërkuese e cila thotë:

Si njësi kërkuese, po Ju drejtohem me kërkesë për anulimin e procedurës së tenderit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës”. Gjegjësisht, pas rishikimit të paramasave dhe parallogarive dhe konsultimeve të kryera me Drejtorinë kompetente për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, konsiderojmë se është e nevojshme të bëhen ndryshimet në paramasa dhe parallogaritje duke shtuar pozicione dhe duke ndryshuar sasi të caktuara.

Për arsyet e lartcekura, kërkojmë anulimin e procedurës së tenderit e cila është në zhvillimin e sipër për projektin “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit GRA618-24-10315-2-1-1.

Ky arsyetim nuk përputhet me asnjë nga mundësitë që i ofron neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-001/2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Duhet ceket edhe kjo se asnjëri nga Legjislacioni Primar / as Sekondar nuk ofron mundësi të anulimit të tenderit për arsyet e cekura nga AK në këtë dokument edhe pse arsyet e tilla janë të pavërteta. Këta të fundit nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi të vetme nëse anulimi i një procedure mund dhe varet mbi nevojën për ndryshime të paramasës. Përpos kësaj me rastin e nënshkrimit dhe aprovimit të DNDF-së, AK përkatësisht njësia kërkuese e ka hartuar saktë paramasën dhe parallogarinë

andaj arsyetimi për anulim kinse nevojën për ndryshim është vetëm një mashtrim dhe tentativë për ta zvarritur projektin. Vlen të thuhet se ka disa vite që ky AK publikon paramasën dhe parallogarinë e njëjtë për tenderin e tillë. Bazuar në këtë shihet se tentativa për anulim me arsyetimin e nevojës për ndryshimin e paramasës është vetëm një farsë dhe mashtrim i opinionit kur dihet se kjo komunë nuk ka pasur as edhe një ndryshim ndikues në infrastrukturën e sajë. Pra shtrohet pyetja, si u bë që ndryshimet e tilla që zakonisht bëhen përmes tenderëve, të i kuptoj njësia kërkuese vetëm kur përfundoi vlerësimin e tenderëve. Edhe më e çuditshme bëhet kur dihet se vet njësia kërkuese bënë ndryshimet në infrastrukturë andaj kërkesa kinse ka ndryshime nuk është aspak e vërtetë. Edhe po të kishte ndonjë, ato janë pa ndikim dhe se ligji i prokurimit nuk lejon anulim të tenderit për një arsye të tillë pas procedurës së hapjes së tenderëve.

Gjithashtu edhe Planifikimi i Prokurimit i AK-së e ka përfshi këtë procedurë dhe e ka treguar kohën e implementimit të sajë, ku mos respektimi i sajë e shtynë AK-në drejt shkeljeve të reja të ligjit lidhur me mos respektimin edhe të planit të prokurimit që vet e ka hartuar.

Kërkesa e njësisë kërkuese është plotësisht e pa logjikshme dhe shihet hapur si favorizim në një mundësi të dytë e GOE që e kanë kryer këtë kontratë gjatë viteve të kaluara. Si është e mundur që 6 vite radhazi i njëjti GOE/OE ta realizoj kontratën me pozicionet e tilla ndërsa tani kur u pa se e humbi kontratën në mënyrë meritore, njësia kërkuese i del në ndihmë me kërkesa për ndryshime të paligjshme të paramasës dhe parallogarisë.

Edhe AK mban një faj të madh në shkeljet e krijuara sepse me vetëdije po tenton ta zvarris kontraktimin me të vetmin qëllim kalimin tek kontraktimi përmes procedurës së negociuar të prokurimit nga ku mendohet se do ta kontraktoj prapë të njëjtin GOE sikur viteve tjera. Vet fakti që sezona e dimrit veç ka fillua, ndërsa AK akoma mendon të ri-tenderoj aktivitetin, tregon se duhet detyrimisht me bë kontratë në formë të negociuar e mandej dihet se kush do

9/11

jetë fituesi. Sipas ligjit është e ndaluar që me neglizhencë të qëllimshme dhe me mos respektim të rregullave të LPP-së, të kalohet tek aplikimi i procedurës së negociuar për

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit: “GRA618-24-10315-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA

projekt që është i planifikuar qysh para një viti.

Ja si duken mundësitë që i ofron LPP dhe RRPP për ndërprerje të aktivitetit të prokurimit pas

hapjes së tenderëve:

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:
 - 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:
 - 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Ndërsa sipas RRPP-së përkatësisht nenit 43, mundësitë për anulim duken kështu:

- 43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
- a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
 - b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
 - c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike komizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
 - d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
 - e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
 - f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
 - g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
 - h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
 - i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
 - j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i riparueshëm; ose
 - k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i riparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Nga kjo po shihet se asnjëri nga nenet nuk ja lejon AK-së anulim e tenderit në këtë fazë sipas arsyetimeve që ai ka paraqitur në njoftimin për anulim. Arsyetimi i AK-së për anulim të

tenderit me kinse konstatimin që projekti duhet të ri tenderohet me qëllim të ndryshimit të paramasës, është plotësisht në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RRPP-së. Si projekt i

tillë nuk mundet më të ndryshohet apo shtyhet për kohë tjera pa asnjë arsye bindëse e sidomos kur dihet se tani më veç jemi në sezonin dimëror. Këto arsye të AK-së janë vetëm sa për të mos na e dhënë neve tenderin dhe asnjëra nga arsyetimet e cekura më lartë nuk është e bazuar, nuk është e argumentuar dhe nuk është as e faktuar. Problemet që i ka shkaktuar vet AK me vonesë të kryerjes së vlerësimit tani po mundohet të i mbuloj me arsyeime boshe kinse paramasa duhet të ndryshohet. Edhe arsyetimi se gjoja kanë ndryshuar nevojat nuk është e vërtet sepse në paramasë dhe parallogari janë të parapara të gjitha nevojat e AK-së dhe nuk ka se çfarë të shtohet më. Për ndonjë ndryshim të vogël e të paparashikuar, LPP i ka paraparë edhe dispozitat ligjore tjera që e lejojnë mundësinë e ndryshimeve apo devijimeve të tilla e që tregojnë se s'ka nevojë për ndryshime.

Nisur nga kjo nuk kemi se si të mendojmë ndryshe për pos asaj që AK po shkelë qëllimisht nenin 62 të LPP-së dhe neni 43 të RRPP-së, vetëm që të mos na japë neve kontratën në fjalë si dhe për ti ofruar GOE tjerë edhe një mundësi të dytë fitimit.

6. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar fare kriteret dhe kërkesat që vet i ka vendosur në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Mos respektimi i dëshmime kualifikuese të dy GOE që ishin konkurrent, mos respektimi i dëshmime për organogramin dhe mos vlerësimi i drejtë dëshmime për pajisjet e kërkuara, janë tregues të mjaftueshëm për të konstatuar se AK ka shkelur plotësisht nenin 69 të LPP-së. Këtë e vëreni nëse i shihni me kujdes dëshmitë e paraqitura në tenderin e GEO të cekura më lartë të cilat tregojnë se ata ishin plotësisht të papërgjegjshëm. Pra mos vlerësimi sipas kriterëve të nenit 69 të LPP-së dhe shkuarja direkt në anulim të tenderit pa asnjë arsye ligjore, konsiderohet shkelje e plotë e nenit 69 të LPP-së.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit të OE "VIA EGNATIA SH.P.K. & Enggroup SH.P.K." lidhur me tenderin "Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja

dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” i iniciuar dhe administruar nga KUVENDI KOMUNAL I GRAÇANICËS. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - KUVENDI KOMUNAL I GRAÇANICËS dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej Grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K. & Enggroup SH.P.K.”

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit - Speciofikacioni teknik

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Njoftimi mbi vendimin e AK)

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit: “GRA618-24-10315-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA



KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës

Nr i prokurimit	GRA618-24-10315-2-1-1
Nr i brendshëm	GRA618-024-036-211

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Zajednica ponuditelja NNT ABC SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K., 20 QERSHORI, 11000, Podujeve	1372530.00
2.	Zajednica ponuditelja B CORP SH.P.K.; FS C ING SH.P.K., Rr. Garibaldi H17/13.1, 10000, Prishtine	1261960.00
3.	Zajednica ponuditelja VIA EGNATIA SH.P.K.; Enggroup SH.P.K., Rr. Mustafë Veselaj, 10000, Prishtinë	1172455.00

KOMUNA E GRAÇANICËS anulon¹ aktivitetin e prokurimit bazuar në kërkesën e njësisë kërkuese e cila thotë:

Si njësi kërkuese, po Ju drejtohem me kërkesë për anulimin e procedurës së tenderit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës”. Gjegjësisht, pas rishikimit të paramasave dhe parallogarive dhe konsultimeve të kryera me Drejtorinë kompetente për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, konsiderojmë se është e nevojshme të bëhen ndryshimet në paramasa dhe parallogaritje duke shtuar pozicione dhe duke ndryshuar sasi të caktuara.

Për arsyet e lartcekura, kërkojmë anulimin e procedurës së tenderit e cila është në zhvillimin e sipër për projektin “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit GRA618-24-10315-2-1-1.

Data: **30.10.2024.**

VENDIMI MBI RISHQYRTIM

KËRKESË PËR RISHQYRTIM NË BASHKËNGJITJE.

DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Graçanicë, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore të gjitha janë të cekura më lartë. Në zbatim të, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerr këtë përfundim:

Ne kemi anuluar këtë aktivitet të prokurimit, për arsye se na është kërkuar nga Njësia Kërkuese që të mos vazhdohet me këtë aktivitet prokurimi pasi kane ndodhur gabime në paramase apo lëshime, e me të cilat do të ishte e pamundur përfundimi me sukses i ketij aktiviteti. Pasi siq dihet në territorin e Komunes së Graçanicës është ndërtuar infrastrukture e re viteve të fundit, si dhe njësia kërkuese ka vërjetur mangësi apo mungesë të disa pozicioneve të domsdoshme në paramase dhe paralogari pa të cilat do të ishte mirembajtje gjysmake apo jo e plot si e till do të neglizhonte një pjesë të territorit dhe kësisoji do të ndikonte negativisht në përditëshmeri të qytetarëve të këtij vendi si në zonen urbane ashtu edhe në ato rurale për pjesen e mospërfshire.

Me rikërkesen e Njesis Kërkuese ka ndryshuar sasit, dhe vlera financiare e projektit.

Andaj anulimi i aktivitetit është bërë para se të bëhet vlersimi i ofertave të dorëzuara.

Po të vazhdonte me këtë aktiviteti siq ka qenë do të ishte i dëmshëm dhe i porealizuar për Komunen e Graçanicës.

Konkluzion:

- I. Refuzohet Kërkesa për Rishqyrtim e tenderuesit VIA EGNATIA SH.P.K., si e PA BAZUAR, për tenderin "Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës", me numër të prokurimit: GRA618-24-10315-2-1-1.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - VIA EGNATIA SH.P.K.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.1121/24, katë bëjë me arsyen e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit, ku sipas AK-KK Graçanicë nga njësia kërkuese është kërkuar të anulohet aktiviteti i prokurimit pasi :

“KOMUNA E GRACANICËS anulon[1] aktivitetin e prokurimit bazuar në kërkesën e njësisë kërkuese e cila thotë:

Si njësi kërkuese, po Ju drejtohem me kërkesë për anulimin e procedurës së tenderit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës”. Gjegjësisht, pas rishikimit të paramasave dhe parallogarive dhe konsultimeve të kryera me Drejtorinë kompetente për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, konsiderojmë se është e nevojshme të bëhen ndryshimet në paramasa dhe parallogaritje duke shtuar pozicione dhe duke ndryshuar sasi të caktuara.

Për arsyet e lartcekura, kërkojmë anulimin e procedurës së tenderit e cila është në zhvillimin e sipër për projektin “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit GRA618-24-10315-2-1-1.”.

OE ankues pretendon se anulimi i aktivitetit nuk është bërë në pajtim me asnjë dispozitë të LPP-së apo legjislacionit sekondar që parashikon anulimin e aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave.

Sipas OE ankues arsyetimi dhe vendimi i AK-së është i pabazë dhe përbën shkelje të nenit 6, 7, dhe 62 të LPP-së, si dhe neni 43 të RRPP-së.

Ndër të tjera OE ankues potencon se :

“..Ky anulim dyshohet se po bëhet për të i favorizuar dhe për të ju dhënë edhe një mundësi GOE-ve që tani në këtë tender nuk kanë arritur të jenë të përgjegjshëm dhe nuk kanë arritur të ofrojnë as çmimin më të ulët.”

Pas analizimit të shkresave të lëndës, njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe vendimit mbi kërkesë për rishqyrtim, vlerësojmë se anulimi i aktivitetit është bërë në kundërshtim me dispozitat e neni 62 të LPP-së pasi nuk ka shkelje të ligjit të cilat kërkojnë anulimin e aktivitetit.

Sqarojmë se AK- KK Graçanicë as në njoftim mbi vendim të AK-së, e as në vendim të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, nuk kanë qenë në gjendje të japin një sqarim ose arsyetim konkret cilat qenkan ato pozicione apo sasi të cilat AK ka nevojë ti ndryshoj.

Përveç kësaj, edhe sikur të ishin të vërteta arsyetimet e AK-së se kanë harruar të vendosin disa pozicione apo sasi, përsëri kjo nuk do ishte bazë e mjaftueshme ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç kërkohet me LPP-së.

Në rastin konkret vlerësojmë se e vendimi i AK-së është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së për përfundimin e aktivitetit të prokurimit, e po ashtu vlerësojmë se përbën shkelje të neni 6 të LPP-së sa i përket ekonomicitetit dhe efikasitetit.

Vlen të theksohet se, nëse pretendimet e AK-së për nevojën e pozicioneve/sasive shtesë “vërtetë” ekzistojnë, AK ka mundësi ligjore në pajtim me nenin 35 par.2, nënpar.2.4, qëpunët aposhërbimet edhetëndarangaekzekutimiikontratësorigjinale, janërreptësishtëtëdomosdoshmepërkompletim të kontratës, kontrata shtesë ti ipetoperatoritekonomik qëështë duke iekzekutuarshërbimet ose punët fillestare.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.2

Pretendimet tjera ankimore kundretjt dy OE-ve tjerë (me çmim më të lart se OE ankues), fillimisht se të dy këta OE për pozicione të njëjta kanë dhënë çmime identike me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore në kundërshtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe kundërshtim me nenin 77.111 të RRPP-së.

Pas analizimit të ofertave të dy OE-ve tjerë pjesëmarrës, kemi gjetuse për pozicionet 2.11, 2.10 kanë ofruar çmimet 0.004€ dhe për pozicionin 1.04 dy OE-të kanë ofruar çmim 0.001€.

Pas analizimit të dosjes së tenderit kemi gjetur se te pika 20.1 theksohet :

*“Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. **Çmimi i ofertuar** lejohet që të shenohet me maksimum dy (2) numra pas preses dhjetore. Çdo numer i shenuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertes.”*

Ndërsa sipas nenit 17.11 të RRPP-së :

*“Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. **Nëse OE ofron çmim me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme.** Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t’u përcaktoj në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde.”.*

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se dy ofertuesit tjerë (përveç se me çmim më të lartë se OE ankues) kanë ofruar çmime në kundërshtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 17.11 të RRPP-së, rrjedhimisht vlerësojmë se pretendimet ankimore në këtë pike janë të bazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt OE-ve tjerë rreth pajisjeve konsiderojmë se janë pjesërisht të bazuara e po ashtu nuk është kthyer përgjigje nga AK në këto pretendime, megjithatë nuk e shohim të arsyeshme të lëshohemi në analizë të mëtutjeshme për dy OE-te tjerë, përderisa kemi defekte në ofertat e tyre sa i përket çmimit, të cilat defekte janë të pakapërcyeshme.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit: “GRA618-24-10315-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës” me numër të prokurimit: “GRA618-24-10315-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **VIA EGNATIA SH.P.K.**

